

UDHËZIM
Nr.98, datë 15.1.2007

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE “PËR
ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 18 SHKURT 2007”**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dekretit të Presidentit të Republikës nr.5194, datë 14.1.2007 “Për caktimin e datës 18 shkurt 2007 për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore”, të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004, ligjin nr.9341, datë 10.1.2005, ligjin nr.9371, datë 14.4.2005 dhe ligjin nr.9676, datë 13.1.2007,

UDHËZOJ:

1. Sipas listës së marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të përdorur për zgjedhjet e vitit 2005 brenda datës 21 janar 2007, zyrat e gjendjes civile, nën autoritetin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, mbështetur në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile, kryejnë përditësimin e listës si më poshtë:

a) evidentojnë dhe regjistrojnë të gjithë shtetasit që kanë mbushur moshën 18 vjeç pas datës së zgjedhjeve të fundit, duke përfshirë edhe ata që mbushin moshën 18 vjeç deri në datën 18 shkurt 2007;

b) evidentojnë dhe regjistrojnë në listën zgjedhore të njësisë së qeverisjes vendore zgjedhësit që janë regjistruar, shtuar në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile të kësaj njësie pas zgjedhjeve të fundit;

c) evidentojnë dhe çregjistrojnë zgjedhësit, që nuk figurojnë më në regjistrin themeltar me vendbanim të zyrave të gjendjes civile, për arsye se kanë vdekur ose kanë lënë shtetësinë shqiptare pas zgjedhjeve të fundit;

ç) evidentojnë dhe çregjistrojnë nga lista zgjedhore e njësisë së qeverisjes vendore, zgjedhësit të cilët janë në listë, por nuk ndodhen në regjistrin themeltar me vendbanim të kësaj njësie;

d) korrigjojnë problemet e evidentuara në listat e mëparshme, duke u bazuar në informacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe duke bërë kontrollin e tyre në regjistrat themeltarë me vendbanim.

2. Jo më vonë se data 21 janar 2007, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën ndarjen e zgjedhësve sipas zonave të qendrave të votimit të zgjedhjeve të fundit dhe u cakton atyre numrin e qendrës përkatëse të votimit. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit, përgatit hartën e njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën janë vendosur edhe kufijtë e zonave të qendrave të votimit dhe e shpall atë në mjedise publike, me hyrje të lirë, brenda njësisë së qeverisjes vendore. Kryetari i njësisë përkatëse mban të pandryshuar vendndodhjen dhe adresën ekzistuese të qendrës së votimit dhe, kur kjo është e pamundur, ndryshimi bëhet me miratim të KQZ-së. Ai nuk mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në 25 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveçse në rastet e forcave madhore.

3. Listat paraprake shpallen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore jo më vonë se data 21 janar 2007, pranë zyrave të njësisë përkatëse dhe çdo qendre votimi, duke i vendosur në mjedise publike me hyrje të lirë për shtetasit. Një kopje e këtyre listave u dërgohet zyrave të gjendjes civile përkatëse, të cilat përditësojnë në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile numrin e zonës së qendrës së votimit për çdo zgjedhës. Një kopje tjetër e këtyre listave i dërgohet menjëherë në format elektronik Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

4. Për përgatitjen e listave të zgjedhësve, NJQV-të përdorin vetëm programin kompjuterik të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi